BASH...A M/
Zyra e Prot
Nr. 1421 Pr...
Date 23.02.2023 ...krimi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR
KORCE

Korçë, me 20.02.2023

**<u>SHPALLJE VENDIMI</u>**

**Drejtuar : Bashkise Maliq**

Per: shtetasin : Kostandin Avdolli, me adrese Vlocisht Maliq

Bashkalidhur po ju dergojme shpalljen per vendimin civil nr. 675 dt. 12.10.2022 per t'u afishuar nga ana Juaj njoftimi me shpallje me afat *20 ditor,* pasi deftesa e komunikimit eshte kthyer me shenimin : " Larguar " dhe pas afishimit kjo shpallje te <u>na kthehet e konfirmuar</u> me vule e firme, ne gjykate.

**KANCELARE**
**Geralda Kasuli**

U afishua sot ne date -----------------------
Per Bashkine Maliq
Nenpunesi ____________________________
(emer, mbiemer, firme)

- Z. Infor Informacionit
dt 23.02.2023

RR 348 530 249 AA

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR**
**KORÇË**

**Nr.Regj.Them.21234-00358-41-2021 (238/807)**
**Dt.Regj. 03.03.2021**

**Nr.Vendimi 41-2022-2985 (675)**
**Dt. Vendimi 12.10.2022**

# VENDIM
## "NË EMËR TË REPUBLIKËS"

Gjykata e Rrethit Gjyqesor Korçë e përbërë nga
**GJYQTAR: ARBEN LERA**

Asistuar nga sekretare gjyqësore Elida Hymeti, në Korçë, sot më dt.12.10.2022 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen civile me Nr.Regj.Them 21234-00358-41-2021 (238/807), Dt.Regj 03.03.2021 që i përket:

**PADITES: Mariglen Pine,** i biri i Sotiraqit dhe i Marianthit, i dtl. 03.05.1990, lindur dhe banues ne Korçe, perfaqesuar me prokure te posaçme nr.349 rep, nr.222 kol dt. 20.01.2020 nga av. Ermir Skënderi, i Dhomes se Avokatise Korçe, me dijeni ne mungese.

**I PADITUR: Kompania e Sigurimeve "SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA" SH.A,** perfaqesuar me autorizimin dt.17.06.2021 nga shtetasi Koço Josifi, ne mungese.

**PERSON I TRETE: Kostandin Avdolli,** identifikuar me karte identiteti nr. I50211033E, ne mungese.

**OBJEKTI:** Shpërblim dëmi pasuror dhe jopasuror (biologjik, moral dhe ekzistencial) për shkak të dëmtimeve në shëndetin e paditësit Mariglen Pine si pasoje e aksidentit te ndodhur ne daten 30.05.2017.

**BAZA LIGJORE:** Neni l, pika "c" dhe "c", Neni 11,13 te Dekretit te Presidentit te Republikes nr. 295, dt. 15/09/1992 "Per sigurimin e detyrueshem te mbajtesve te mjeteve motorrike per pergjegjesine ndaj personave te trete", ndryshuar me ligjin nr.7641 dt. 01/12/1992 dhe ligjin nr.8279 dt.18/01/2001, Neni 7, pika 10 e Ligjit nr. 9267, dt. 29/07/2004 "Per veprimtarine e sigurimeve, risigurimeve dhe ndermjetesimit ne sigurime dhe risigurime", Ligji nr. 10076, dt. 12/02/2009 "Mbi sigurimin e detyrueshem ne mjetet e transportit", Rregullorja nr.53 date 25/06/2009 nxjerre nga Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare ne zbatim te ligjit te sipercituar, Kodi Civil i miratuar me ligjin nr. 7850,dt. 29/07/1994, Neni 450, Neni 608, 625, 640 e ne vijim te tij, Neni 25, 26 te Rregullores se Ministrit te Financave nr. 622/1,dt. 15/12./1992, Udhezimi nr. 24, dt. 15/11/2007 i Ministrit te Financave "Mbi trajtimin e demeve te mbuluara nga Kontrata e Sigurimit te mbajtesve te mjeteve motorrike per pergjegjesine ndaj paleve te treta", Vendimi nr. 12, dt. 14/09/2007 i Kolegjeve te Bashkuara te Giykates se Larte.

Gjykata pasi verifikoi prezencen e paleve ku rezultoi qe perfaqesuesi i paditesit Mariglen Pine, av. Ermir Skenderi nuk eshte paraqitur ne gjykim megjithese ka mare dijeni rregullisht.
Perfaqesuesi i te paditurit Kompania e Sigurimeve "SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA" SH.A, ne mungese.
Personi i trete, Kostandin Avdolli, ne mungese.

Gjykata pasi shqyrtoi aktet dhe bisedoi në tërësi çështjen

**PARASHTRON:**

Kerkuesi Mariglen Pine ne dt. 03.03.2021 ka paraqitur prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Korçe kerkese padine me objekt shpërblim dëmi pasuror dhe jopasuror (biologjik, moral dhe ekzistencial) për shkak të dëmtimeve në shëndetin e paditësit Mariglen Pine si pasoje e aksidentit te ndodhur ne daten 30.05.2017.

Ne seancen gjyqesore te dates 12.10.2022, Gjykata konstatoi se perfaqesuesi i paditesit Mariglen Pine, av. Ermir Skenderi nuk eshte paraqitur ne gjykim ndonese rezulton te kete mare dijeni rregullisht per daten dhe oren e gjykimit.

Rezuton se nuk u paraqiten ne gjykim perfaqesuesi i pales te paditur Kompania e Sigurimeve "SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA" SH.A dhe i personi i trete shtetasi Kostandin Avdolli te cilet kane mare dijeni rregullisht per gjykimin.

Nga gjykata eshte qendruar ne pritje brenda nje afati te arsyeshem ne sallen e planifikuar per zhvillimin e gjykimit duke e perseritur vazhdimisht thirjen per paraqitjen e perfaqesuesit te paditesit.

Nga perfaqesuesi i paditesit Mariglen Pine nuk rezulton te jete bere me dije per gjykaten ndonje shkak i perligjur lidhur me kete mosparaqitje, sikurse nuk rezultoi te jete depozituar ne sekretarine gjyqesore ndonje kerkese per shtyrje te gjykimit apo per te justifikuar mungesen e tij ne gjykim.

Ne keto kushte, referuar nenit 299/c te K.Pr.Civile ku citohet se: "*Gjykata vendos pushimin e gjykimit kur....*c) *Pushimi i gjykimit parashikohet shprehimisht ne ligj,* Gjykata çmon se duhet vendosur pushimi i gjykimit, pasi jemi perpara rasteve te parashikuara nga neni 179/2 te K.Pr.Civile ku citohet se: *"Nëse paditësi, pa ndonjë shkak të arsyeshëm, nuk paraqitet në seancë përgatitore ose në seancë gjyqësore dhe rezulton se ka dijeni rregullisht, Gjykata vendos pushimin e gjykimit, kur i padituri nuk ka dorëzuar deklaratën e mbrojtjes. Kur i padituri e ka dorëzuar deklaratën e mbrojtjes, mund të kërkojë vijimin e gjykimit në mungesë të paditësit dhe gjykata, kur vlerëson se qëndrimi i të paditurit ka shkak të ligjshëm, vijon gjykimin në mungesë të paditësit".*

***Perfundimisht ne kushtet kur rezulton se perfaqesuesi i paditesit Mariglen Pine nuk eshte paraqitur ne gjykim dhe rezulton te kete marre dijeni rregullisht, Gjykata bazuar ne kriteret e dispozitave te sipercituara ka detyrimin ligjor qe te disponoje me vendim per pushimin e gjykimit te çeshtjes.***

Persa i perket shpenzimeve gjyqesore qe rezultojne te jene kryer ne lidhje me tarifen mbi aktet dhe ato te njoftimit te paleve te parapaguara nga paditesi ne kushtet e pushimit te çeshtjes çmohet qe duhet te lihen ne ngarkim te kesaj pale, pra siç jane kryer.

**PER KETO ARSYE**

Gjykata bazuar ne nenin 299/c dhe 179/2 te Kodit te Proçedures Civile

**VENDOSI:**

1. Pushimin e gjykimit te kerkeses civile me Nr.Regj.Them 21234-00358-41-2021 (238/807), Dt.Regj 03.03.2021 qe i perket paditesit Mariglen Pine, i paditur Kompanisë së Sigurimeve "SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA" SH.A, person i trete Kostandin Avdolli, me objekt; Shpërblim dëmi pasuror dhe jopasuror (biologjik, moral dhe ekzistencial) për shkak të dëmtimeve në shëndetin e paditësit Mariglen Pine si pasoje e aksidentit te ndodhur ne daten 30.05.2017.

2. Shpenzimet gjyqesore mbeten ne ngarkim te paditesit Mariglen Pine *(te parapaguara)*.

- Kundër këtij vendimi lejohet të bëhet ankim i veçantë në Gjykatën e Apelit Korçë, brenda 5 (pese) diteve, duke filluar nga dita e nesërme e njoftimit të vendimit te arsyetuar.

U shpall ne Korçe, sot me dt. 12.10.2022.

**SEKRETARE**
**Elida HYMETI**

**GJYQTAR**
**Arben LERA**

Zyra Postare Qendër
AL
22-02-2023
7001
Korçë